

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nafta 229 lekë, më shtrenjtë se në gjithë rajonin, PD akuza Qeverisë: Faji nuk është i luftës, por regjimi i Edi Ramës na vjedh me rritjen e taksave
ADRESA	https://newsbomb.al/politike/nafta-229-leke-me-shtrenjte-se-ne-gjithe-rajonin-pd-akuza-q-everise-faji-i401260
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 12:42:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 12:37:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e8c21e027d5dfa087d58060c6455d484e4e9c5db68422f0e7cb777cb6f3f220a
TEKSTI	5a63877fa2bae06fd4e716e34e041ae3e4a00c35297dc49a8f2f18d27ba43773
PAMJA	ed206c7ed516f4e945b00c8361771b341c3b55e537f3aec31be10a27cb2e05a3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	eedf4f9aeba3ec0e0a45f74deebd1109055a8c53ebef4ef0d94c39b3400c816b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7b60020d12239b3c3f63032b973e8451536e9d643adb77567035503a03c510f7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/eedf4f9aeba3ec0e0a45f74deebd1109055a8c53ebef4ef0d94c39b3400c816b

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjikës

Politikë

15 Shtator 2026, 14:37

Nafta 229 lekë, më shtrenjtë se në gjithë rajonin, PD akuza Qeverisë: Faji nuk është i luftës, por regjimi i Edi Ramës na vjedh me rritjen e taksave



Shkruar nga Newsbomb



Zëdhënësja e Partisë Demokratike, Floriana Garo

Shqipëria dje shënoi çmimin prej 229 lekësh për një litër naftë ose 2.48 euro, duke u renditur e para në Ballkan dhe e dyta në kontinent, pas Danimarkës, me çmimin më të shtrenjtë. Partia Demokratike dënon këtë fakt dhe thotë se qytetarët po vidhen nga regjimi i Edi Ramës.

"Nafta 229 lekë nuk është thjesht një produkt dhe një çmim, por është një politikë e vjedhjes me anë të rritjes së taksave. Fakt është që secili nga vendet kufitare me ne nuk e ka ndryshuar çmimin as dje, as sot: Mali i Zi e shet me 1.87 euro, Kosova me 1.76-1.85 euro, Maqedonia e Veriut me 1.64 euro", u shpreh zëdhënësja Floriana Garo.

Partia Demokratike merr rastin e Ukrainës, që është vend në luftë, e ka çmimin e naftës 1.35 euro për litër. Por edhe vendet e rajonit e kanë më lirë naftën se në Shqipëri dhe sipas Partisë Demokratike, kjo vjen për shkak të politikave që këto vende ndjekin.

"Qeveria e Malit të Zi e ka ulur akcizën e naftës deri në 50% në kohë krizash. Serbia deri në 25% dhe ka aplikuar çmime tavan. Maqedonia e Veriut aplikon vetëm dy taksa kryesore, akcizë dhe TVSH, ndërsa taksa e qarkullimit merret direkt tek automjetet, dhe jo përmes çmimit për litër të karburantit, duke e mbajtur barrën fiskale më të ulët.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje

Lajmet e fundit



Bota

Pamje tronditëse nga Franca!! I ri shtyhet me forcë nga policia dhe përplas kokën, humb jetën pas 13 ditësh në spital



Rajoni

Mbylli sytë sot në moshën 76-vjeçare, kush ishte Flora Brovina, grua që puthi tokën e Kosovës pasi u liria nga serbët! Historia e një jete mes dhimbjes, luftës dhe qëndresës

Zbulu më shumë artikuj

Kosova ka përdorur herë pas here rregullimin e përkohshëm të marzheve dhe çmimeve maksimale të tregtimit përmes vendimeve të ministrisë përgjegjëse për tregtinë. I vetmi që nuk pranon të marrë asnjë masë, por të vijojë të shtojë barrën fiskale për shqiptarët dhe familjet e tyre, është Edi Rama", vijon deklarata e zëdhënësës së PD.

Floriana Garo thekson se Partia Demokratike në fushatën elektorale të vitit 2025, premtoi përgjysmimin e taksave të karburantit, ndërkohë që këtë kërkesë ia ka drejtuar publikisht edhe qeverisë Rama. Sipas saj, në rast se do të ndiqej kjo politikë, çmimi i naftës sot do të ishte 1.71 euro për litër, pra në mesataren e rajonit dhe jo ndër çmimet më të shtrenjta në Evropë.

Partia Demokratike i fton shqiptarët në protestë dhe thekson se ata duhet ta kenë të qartë se çdo ditë që kryeministri Edi Rama qëndron në pushtet, aq më shumë rritet rëndesa ekonomike për popullin dhe ulët siguria.

"Shqiptarët duhet të kuptojnë se përgjegjës për këtë gjendje nuk janë konfliktet botërore, siç gënjen Rama, sepse e njëjta gjë do të kishte ndodhur edhe në Maqedoni dhe Kosovë. Përgjegjës për këtë gjendje është vetëm një njeri dhe e ka emrin Edi Rama.

Prandaj thirrja që demokratët, socialistët dhe të pavarurit t'i bashkohen protestës qytetare merr vlerë sot më shumë se kurrë. 'Rama, jepe dorëheqjen' dhe 'zgjedhje të lira garantuar nga një qeveri kujdestare', nuk janë ankesa dhe kërkesa, por domosdoshmëri kombëtare", përmbyllet deklarata.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Martë 13:12

Berisha u takua me kongresmenët amerikanë, Evi Kokalari tregon prapaskenat e bujshme: U sponsorizuan nga pronari i klubit të striptizimit, mik i Mediut



Politikë



Politikë

Gjykata e Lartë ia në burg Erion Vellajn, Plarent Ndreca i shqetësuar për demokracinë e vendit: Pasojat prekin qytetarët, do e ndjekim edhe më tej

E Martë 12:08

Kryeministri Rama në Napoli, vizitë në Katedrën e Gjuhës Shqipe pranë Universitetit "L'Orientale"

E Martë 11:57



E Martë 11:37

Ndërtimi i paligjshëm pengon vendosjen e ashensorit në pallatin ekzistues, Braçer akuza IMT-së dhe UKT-së: Më "shitën" se mbrojnë paligjshmërinë



Politikë

Shuhen shpresat për Erion Vellajn, Gjykata e Lartë e lë në burg

E Martë 11:06



Politikë

Dy nënkryetarë të rinj në Bashkinë e Benet Becit, njëri prej tyre kryetari i PS-së në Shkodër, kryebashkiaku i prezanton para ekipit drejtues

E Martë 10:19



E Hënë 22:59

Xhelal Mziun e kap "euforia" e protestës dhe bën gafën, publikon videon nga Mali i Zi dhe ia taks gjimnazit "Qemal Stafa"



Politikë

"Të zhduk", incidenti i Ramës në avion me emigrantin shqiptar, Çim Peka nxjerr fotot: E ka kapur me thonj dhe e ka kërcënuar

E Hënë 22:15



Politikë

La vendin "vakant" me shpresën se do të kthehet?! Pse Erion Veliaj vendosi të mos delegonte detyrën e kryetarit

E Hënë 21:59



E Hënë 21:24

Erion Veliaj do të dalë nesër nga burgu? Plarent Ndreca në Top Story: Nesër presim lirin e tij, ja pse



Politikë

"Të q**** r*** o Edi Rama", incident në avionin ku po udhëtonte kryeministri, momenti kur ai dorëzon në duart e karabinierëve shqiptarin që e shau (VIDEO)

E Hënë 20:14



Politikë

Edi Rama reagon sërish për rrogat e gjyqtarëve, tregon "vendin" e Kushtetueses: Vetëm qeveria ka të drejtë për pagat

E Hënë 19:25





🕒 E Hënë 17:52

Begaj vizitë në Emiratet e Bashkuara Arabe, pritët nga zyrtarët e lartë! Ja çfarë u diskutua në takime



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.